



# RAPORT VJETOR 2022

[www.asf.al](http://www.asf.al)

# PËRMBAJTJA

Mesazhi nga Drejtuesja Ekzekutive	04
Struktura Drejtuese e Agro & Social Fund	05
Historik Institucional	07
Rrjeti i degëve	08
Misioni & Vlerat Thelbësore	09
Sfidat dhe Arritjet 2022	10
Qëllime Strategjike për Vitin 2023	11
Arritjet në kredidhënie	12
Menaxhimi i Portofolit në Risk	15
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	17
Marketing 2022	18
IT, Mbrojtja nga Sulmet Kibernetike ne fokus	19
Performanca Sociale	20
Klientët Tanë	22
Raporti i Auditorëve të Pavarur	23
Bilanci	24
Pasqyra e të ardhurave	25
Pasqyra e flukseve të parasë	26
Bashkëpunëtorë tanë	28
Rrjetet tona Sociale	29

# Mesazhi nga Drejtuesja Ekzekutive

Të nderuar klientë, partnerë, punonjës dhe bashkëpunorë,

Pas përpjekjeve 2 vjeçare për të përballuar pasojat e COVID 19, nevojës për të krijuar një koherencë midis objektivit për një aktivitet financiar të qëndrueshëm dhe përgjegjësisë sociale për të minimizuar çdo rrethanë të pafavorshme për individët klientë, nisëm një vit të ri plot shpresa se ringritja është domosdoshmëri dhe secili prej nesh duhet të jetë aty me angazhimin maksimal.

Me këtë objektiv u angazhuan dhe vendosën përpjekjet dhe energjitë nga të gjithë, nga individit apo njësia më e vogël e deri tek strukturat e specializuara në Zyrën Qëndrore. E ngritëm “zërin” dhe, kudo ku identifikua nevojën për praninë tonë – e rritëm atë, përmirësua produktet e shërbyera dhe rritëm profesionalizmin e stafit nëpërmjet një sistemi të vazhdueshëm trajnimi, rifuqam marrëdhëniet e partneritetit me partnerët dhe vijua në identifikimin për partnerë të tjerë rrugës. Gjatë këtij viti ne përmirësua strukturën manaxheriale dhe zgjerua rrjetin e të punësuarve në ASF.

Sigurisht, q nisja e konfliktit ruso-ukrainas, i cili përgjatë vitit 2022 solli në tryezat e qeverive dhe më tepër në tryezat e qytetarëve krizën e çmimeve të produkteve pakkontrolluar u reflektua dhe afektoi dhe Agro Social Fund, për shkak të pozicionimit të konsumatorëve dhe ofruesve të produkteve e shërbimeve në pozita të vështira. Kjo pozitë u reflektua në nivelin e kërkesës për financime e nevojës për konsum, në cilësinë e portofolit dhe mbi të gjitha; në rritjen e kostos së borxhit.

E përtej pengesave dhe situatave jo të favorshme, gjatë vitit 2022, portofoli i kredisë shënoi një rritje prej 18 % krahasuar me një vit më parë duke arritur në rreth 1,037 miliard lekë e klientela shkoi në nivelin e 3,305 klientëve aktivë. Ju shërbyem cilësisht 2,256 klientëve, të cilët disbursuan rreth 805 milion lekë; në formën e kredive të vogla kryesisht në ndihmë të bizneseve të vogla e të mesme përfshirë të vetëpunësuarit, si dhe të individëve.

Ne jemi krenarë që gjatë vitit mundësua përmirësimin e cilësisë së jetës të rreth 5,600 fëmijëve, si dhe të 160 klientëve nga grupet e margjinalizuara dhe ju krijuam gjithashtu mundësinë 200 të tjerëve të ishin sipërmarrës të një biznesi për herë të pare. Siguroam që 57% e totalit të klientëve të jenë të përqëndruar në zonat rurale dhe 47 % e numrit të klientëve të ishin klientë femra, duke mbërritur në fundvitin 2022 me arritje të mira në përbushjen e dimensionit social të misionit tonë. Gjatë këtij viti, siguroam gjithashtu mbështetjen e disa partnerëve strategjik apo lëvruam transhe të reja të bashkëpunimeve të ngritura më parë, duke përmirësuar procesin e sigurimit të fondeve e rrjedhjen e parasë; rritur fashen e besimit dhe bashkëpunimit me institucione të rëndësishme financiare në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

Me besimin tek njëzërit e mirë dhe profesionistë të Agro & Social Fund, duke vendosur një kontakt të drejtpërdrejtë dhe aktiv me çdo klient ose kandidat për të qenë i tillë, me bashkëpunimin dhe besimin e çdo partneri, jam shumë e lumtur të konfirmoj angazhimin në vazhdimësi për të mbështetur më shumë klientë e mundësuar më shumë punësim, në veçanti për të rinjtë, gratë dhe shtresat e margjinalizuara, dhe nxitur zhvillimin e qëndrueshëm.



Faleminderit!

**Rozana OROZI**  
Drejtore Ekzekutive

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Rozana Orozi', located at the bottom right of the page.

# STRUKTURA DREJTUESE E AGRO & SOCIAL FUND

## Agro & Social Fund është e organizuar, si më poshtë:

- Organi më i lartë drejtues është Asambleja Përgjithshme e Ortakut, të cilët kanë zgjedhur një Bord Përfaqësues.
- Në fillim të vitit 2022, me Vendim të Bordit Përfaqësues të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë u krijua Komiteti i Auditit.
- Drejtori Ekzekutiv, zbaton politikat e miratuara nga Ortaku i Vetëm dhe është përgjegjës për drejtimin institucional dhe administrimin e përgjithshëm.
- Mënyra e funksionimit dhe kompetencat që ata kanë janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 të Shoqërive Tregtare si dhe në statutin e Agro & Social Fund .

## ANËTARËT E BORDIT PËRFAQËSUES TË AGRO & SOCIAL FUND



### Kryetari i Bordit,

**Prof. Asoc. Dr. BAJRAM MUÇAJ** është diplomuar pranë Fakultetit të Ekonomisë, ka një diplomë pas-universitare në Menaxhim Biznesi dhe “Doktor i

Shkencave” me Temë: “Institucionet mikrofinanciare në Shqipëri dhe perspektiva e tyre në lidhje me zhvillimin e politikave”. Ai ka marrë titullin Profesor i Asociuar në Korrik të vitit 2011. Ka një përvojë mjaft të gjatë në sektorin e mikrofinancave, që nga Maji i vitit 1999 është Drejtori Ekzekutiv i Fondit Besa. Që në vitin 2002 kryen dhe rolin e Profesorit të Jashtëm. Që nga Shtatori i Vitit 2008 ai mban gjithashtu postin e Drejtorit Ekzekutiv të Fondacionit ABC. Gjatë periudhës Shtator 2000 – Korrik 2005 ka qënë Anëtar Bordin i Komitetit të Mbrojtjes në Bankën e Shqipërisë.



### Anëtar Bordin,

**Prof. Asoc. Dr. Altin MUÇA** është diplomuar pranë Fakultetit të Ekonomisë në vitin 1992. Deri në vitin 2003 ka punuar si Profesor në Departamentin e Marketingut dhe

Turizmit të Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës. Në vitin 2003 ai iu bashkua Fondit Besa në pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Marketingut. Ai ka disa kualifikime nga Departamenti Amerikan i Shtetit dhe nga Agjensia e Bashkëpunimit Ndërkombëtar Japonez. Ka marrë pjesë në disa seminare me temë “Financimi i Tregtisë Ndërkombëtare dhe Marketingu Ndërkombëtar” për të cilat është certifikuar. Në Shtator të vitit 2003 ai mori titullin Doktor i shkencave dhe në Korrik të vitit 2011 mori titullin Profesor i Asociuar



### Anëtar Bordin, Znj.

**Luiza Shehu** me një eksperiencë të gjatë në sektorin Ligjor, është diplomuar në Fakultetin Juridik në vitin 1995. Ka mbajtur pozicionin e Drejtorit në Departamentin Ligjor të Ministrisë

së Bujqësisë dhe Ushqimit. Në vitin 2004 mori një diplomë masteri për Administrim Publik në Universitetin e Nebraskës. Ajo iu bashkua sektorit të mikrofinancës në vitin 2007, në pozicionin e Drejtorit Ligjor, Burimet Njerëzore & Departamentit të Administrimit të Brendshëm në FAF. JSC (ish MAFF). Që në vitin 2016 mban postin e Drejtorit të Departamentit Ligjor të Fondit Besa. Disa përvoja të tjera pune përfshijnë: Pedagoge e Ligjit Bankar dhe Sigurimeve, Eksperte legale e GTZ, Avokate e licënuar që në vitin 2013.

## Agro & Social Fund është i organizuar në 5 departamente:

Departamenti i Kredisë,

Departamenti i Financës,

Departamenti i Menaxhimit të Riskut,


Departamenti i Burimeve Njerëzore & Shërbimeve, Juridikut dhe Marketingut

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit.

Të gjithë drejtuesit e Departamenteve varen nga Drejtori Ekzekutiv dhe secili prej tyre ka staf nënvarësi që ndihmojnë në mirëadministrimin e proceseve të punës.

Agro & Social Fund operon në 6 Degë Rajonale (Tiranë, Durrës, Lushnje, Elbasan, Lezhë dhe Korçë) dhe 5 Nëndegë (Tiranë, Laç, Bilisht, Pogradec, Librazhd),

Në nivel menaxhimi në degë, struktura është: Drejtor Dege, Përgjegjës Dege (sipas vlerësimit), Asistente Dege, Oficerë Kredie dhe Staf Ndihmës.



Organogramma e Shoqërisë  
Agro & Social Fund:

# HISTORIKU INSTITUCIONAL

2001



**Krijohet "Building Future"** Krijohet "Building Future" si program mikrofinanciar i World Vision Albania, fillimisht me hapjen e zyrës së parë në rajonin e Lezhës.

2009



Kalon Institucion  
Mikro- financiar me status ligjor "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar"  
- **Vision Fund Albania.**  
Në pronësi dhe kontroll 100% të VisionFund International degë e World Vision International.

DHJETOR  
2009



**AGRO &  
SOCIAL FUND**  
mori licencën nga Banka e Shqipërisë Nr. 17, si Institucion Financiar i Mikrokredisë.

NENTOR  
2016






VisionFund International vendos tërheqjen e përfaqësisë së tyre nga Shqipëria, kështu që në muajin Dhjetor 2016, u arrit marrëveshja e shitjes së Institucionit tek **Fondi Besa sh.a.**, institucioni financiar jobankar më i madh në Shqipëri.

DHJETOR  
2016



**E deri më tani**  
Fondi Besa është pronari dhe Ortaku i Vetëm i këtij institucioni me zotërimin e 100% të aksioneve.

# RRJETI I DEGËVE TË AGRO & SOCIAL FUND



# MISIONI I AGRO & SOCIAL FUND

## Misioni i Agro & Social Fund

Agro & Social Fund mbështet zhvillimin e qëndrueshëm, përfshirjen financiare dhe kohezionin social, nëpërmjet asistencës së përgjegjshme financiare të ndërmarrjeve mikro e të vogla kryesisht, me qëllim zvogëlimin e varfërisë, lehtësimin e përmirësimit të jetesës dhe zgjerimin e oportuniteteve për punësim, duke operuar kryesisht në zonat rurale e semi-urbane, por dhe ato urbane.

## Vlerat e Agro & Social Fund

Agro & Social Fund është i fokusuar në përmirësimin e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve që i ofrohen klientelës së synuar, kryesisht nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm të kërkesave të tyre, krijimit të mundësive për klientët, familjet dhe komunitetet në rritjen e mirqënies, uljen e varfërisë apo vulnerabilitetit, rritjes së aksesit në financë, krijimit të vendeve të reja të punës apo dhe shtimit të vlerës së atyre ekzistuese.

Në rrugëtimin tonë të udhëhequr nga misioni, ne ruajmë e pasurojmë vlerat tona.

**Ne përpiqemi t'i shfrytëzojmë këto vlera me qëllimin që të sigurojmë punonjës të motivuar dhe të orientuar drejt rritjes së rezultateve dhe mbrojtjen nga devijimi i misionit, punonjës që do arrijnë të zhvillohen e veprojnë në sintoni të plotë me linjën për rritjen e objektivave të institucionit.**



Ne jemi të përkushtuar për të punuar pranë njerëzve, me qëllim nxitjen e përmirësimit të jetesës së tyre



Ne jemi besnikë ndaj qëllimit dhe të përgjegjshëm për burimet që na janë besuar, duke i menaxhuar ato në mënyrë të tillë që të sjellin kthimin maksimal për kompaninë dhe klientët tanë



Ne vlerësojmë njerëzit, i konsiderojmë të barabartë dhe u japim atyre përparësi atyre përkundrejt fitimit e qëllimeve tradicionale të biznesit, strukturave e sistemeve



Ne jemi punonjës dhe një kompani e besuar në treg – ajo e cila qëndron për integritetin dhe vendos një standard për të, duke frymëzuar të tjerët të jenë gjithmonë të besueshëm dhe të ndershëm



Ne vlerësojmë e promovojmë transparencën dhe sjelljen etike



# SFIDAT & ARRITJET 2022

Viti 2022 pritej të ishte një vit rikuperimi dhe “shërimi” nga pandemia që po shuhej. Megjithatë, fillimi i vitit nisi me probleme të shtuara. Pushtimi rus i Ukrainës dhe efektet zinxhir që solli ai në rritjen e çmimit të hidrokarbureve, në rritjen e kostove të prodhimit, dhe në përgjithësi, në nivele inflacioni të pahasura në dekada, patën ndikim të rëndësishëm në jetën ekonomike të familjeve, bizneseve të vogla e të mesme në Shqipëri. Pavarësisht vështirësive të hasuara, në përgjithësi viti 2022 rezultoi të ishte një vit pozitiv për Agro & Social Fund. Rezultati financiar ishte i kënaqshëm, arritëm të firmosim bashkëpunime me partnerë të rinj kombëtar e ndërkombëtar, zgjeruam bashkëpunimin me partner aktualë. Në mënyrë të përmbledhur:

- Administruam një portofol prej rreth 1.037 miliardë lekë. Në shifra kumulative përgjatë këtyre viteve ju është shërbyer rreth 30,973 klientëve, duke disbursuar rreth 6.3 mld Lekë.
- Agro & Social Fund, ndër vite paraqitet me një trend pozitiv të rritjes së portofolit: 28% (2019), 19.3% (2020), 14% (2021) dhe 18% (2022).
- Në mbyllje të vitit 2022, 57% e klientëve i përkisnin zonave rurale dhe 47% kliente femra.
- Një staf prej 84 punonjësish ishte në shërbim të 3,305 klientësh
- Retention RATE (Raporti i Ruajtjes së Klienteles) 70%.
- Nga të dhënat e mbledhura rezultoi që me financimet tona, kemi ndikuar jetën e rreth 5600 fëmijëve, në mënyrë direkte apo indirekte.
- Gjatë fillimit të vitit, pasi kaluam me sukses të gjitha proceset e parashikuara, nënshkruam marrëveshjen me EIF, për shumën prej 1 mln Euro, dhe po në atë periudhë u kalua dhe transhi i parë i cili u vendos në dispozicion të klientëve tanë, nëpërmjet një produkti të dizenuar enkas për këto fonde.
- Përmbyllëm marrëveshjen me OTP Bank për vënien në përdorim të fondeve të përfituara nga marrëveshja me Frankfurt School.
- Gjatë vitit 2022 arritëm 2 marrëveshje, me Easy Pay dhe Unionnet Eastern Union, duke iu dhënë mundësinë klientëve tanë për kryerjen e pagesave në pikat më të afërta që gjenden pranë tyre.
- Ka vijuar ngritja e fondeve me partnerin KIVA (vlerësuar për shkak të fee-ve të ulta të fondeve sipas kategorive dhe gjatë vitit 2022 duke e vlerësuar bashkëpunimin mes nesh si të sukseshëm, Kiva vendosi të rrisë limitin e fondeve deri në 1.5 mln euro.

# “Member Engagement Award” për Borrow Wisely

E kthyer tashmë në traditë, gjatë muajit Tetor u lançua fushata Borroë Ëisely, kësaj here nën nismën e vetë ASF, pasi MFC informoi që kësaj here për shkak të reformatimit që po i bëhet kësaj fushate, nisma do të ishte në varësi të dëshirës dhe mundësisë së vetë institucionit. ASF vendosi të vijojë me traditën e ndërgjegjësimit mbi huadhënien dhe edukimin financiar për klientët tanë, dhe jo vetëm.

Për shkak të punës tonë disavjeçare në këtë fushtë, gjatë Konferencës së MFC, mbajtur në Stamboll, ASF iu akordua një çmim për pjesëmarrje dhe angazhim në promovimin e standarteve globale të mbrojtjes së konsumatorit, nëpërmjet fushatës Borroë Ëisely!



# QËLLIME STRATEGJIKE PËR VITIN 2023

- ASF deri në fund të vitit 2023 synon të ketë arritur në një portofol kredie me vlerë absolute prej 1.175 mld lekë (~10 mln Euro) dhe një klientelë aktive rreth 3780 klientë;
- ASF deri në fund të vitit 2023 synon të ketë disbursuar kredi për rreth 2,940 klientë, me një shumë të disbursuar prej 918 mln lekë (7.8 mln Euro);
- ASF do përdorë të gjithë burimet e veta, në formën më të mirë, për të mbajtur NPL-të në nivelin e parashikuar jo më shumë 4 % si dhe do synojë shtimin apo përmirësimin e instrumenteve për kontrollin e risqeve kyçe që kërcënojnë organizatën;
- ASF deri në fund të vitit 2023 synon të zgjerojë shtrirjen dhe mbulimin me shërbime financiare në zona të tjera rurale e gjysmë urbane, nëpërmjet konsolidimit të zyrave ekzistuese e shtimit të një dege të re;
- ASF synon të përmirësojë ofertën e produkteve të saj nëpërmjet përmirësimit të produkteve në tërësi, në koherencë me zhvillimet dhe duke ju përshtatur nevojave të klientelës;
- ASF deri në fund të vitit 2023 edhe në kuadër të nismës për të kontribuar në edukimin financiar do të ndërmarrë organizimin e disa aktiviteteve për të siguruar përcjelljen e njohurive të nevojshme si dhe për të zgjeruar njohuritë në këtë drejtim për grupe të tjera të caktuara, të cilat do të synohen të realizohen nëpërmjet fondeve të veta apo mbështetjes së fituar me asistencë teknike apo projekte nga entitete të mbështetura nga EU, MFC, Sëiss Contact etj;
- ASF synon rritjen e kapaciteteve të stafit nëpërmjet trajnimeve dhe shkëmbimit të eksperiencave si brenda institucionit, ashtu edhe në institucione analoge;
- ASF përgjatë vitit 2023 do rrisë aksionin për të ndërtuar një proces aktiv për konsolidimin e partneriteteve aktuale dhe zhvillimin e kontakteve, bashkëpunimin me partnerë dhe donatorë të tjerë potencialë.

# ARRITJET NË KREDIDHËNIE

Rritja e nivelit të kreditimit ka reflektuar ambicien tonë strategjike për të rritur numrin e klientëve dhe për të mbështetur biznesin e vogël dhe të mesëm që është motorri i ekonomisë së vendit.

Në këtë aspekt, puna jonë ka konsistuar në diversifikimin e portofolit të kredisë, çka çon në diversifikimin e riskut dhe në sigurimin e një aktiviteti të qëndrueshëm.

Viti 2022 është mbyllur me këto shifra

- Rritja e numrit të kredisë aktive rezulton me 3,305 kredi, me një rritje prej 6% për vitin 2022
- Rritja e portofolit bruto të kredisë aktive rezulton në vlerën 1.037 mld lekë, me një rritje prej 18% ose 160 milionë lekë per vitin 2022
- Rritja e numrit të kredisë të disbursuara ka qenë 2,256 kredi ose 6% më shumë se vitin e kaluar
- Rritja e volumit të disbursuar ka qenë 805,306,000 lekë ose 16% krahasuar me vitin e kaluar
- Rritja e numrit të kredisë aktive per periudhën 5 vjeçare rezulton me 51% rritje në numër dhe 106% në vlerë

## Viti 2022 në shifra:



Nr Kredi të  
Distribuara



2,256

Kredi Rurale

1,281

Volumi Kredi të  
Distribuara



805 mln lekë

Klient Femra

47%

Portofol Aktiv



1.037 mld lekë


Klient te rinj

48

2022	Nr.	Vlerë
Kredi të Disbursuara	2,256	805,306,000
Portofol Aktiv	3,305	1,037,330,530
Kredi Rurale	1,281	444,916,000
Klientë Vulnerabël	161	51,460,000
Klientë të Rinj	48 %	43 %
Kliente Femra	47 %	45 %

	Kredi të Disbursuara në Nr.	Kredi te Disbursuara në Vlerë (mln lekë)	Kredi Aktive në Numër	Portofol Outstanding (mln lekë)
2018	1,861	514	2,195	503
2019	1,779	556	2,509	643
2020	1,813	564	2,788	768
2021	2,133	695	3,128	877
2022	2,256	805	3,305	1,037

Paraqitje grafike për të gjithë te dhenat



## Disbursime Kumulative

3.7 MLD  
2018

4.3 MLD  
2019

4.8 MLD  
2020

5.5 MLD  
2021


6.4 MLD  
2022

## Fokusi ynë janë klientët

ASF ka punuar gjatë gjithë këtyre viteve që t'i ofrojë klientëve të tij jo vetëm një shërbim cilësor, por edhe produkte kredie të cilat do të përmbushin kërkesat dhe nevojat e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme. Duke qenë të ndërgjegjshëm për nevojat në ndryshim të shoqërisë, ASF investon në mënyrë të vazhdueshme në përmirësimin e produkteve të kredisë apo në hedhjen në treg të



Një risi gjatë vitit 2022 ishte nisja e bashkëpunimit me “European Investment Fund” dhe lançimi i produktit EIF, një produkt i orientuar drejt financimit dhe mbështetjes së bizneseve dhe aktiviteteve bujqësore/blegtorale të formalizura, me interesa dhe komisione preferenciale duke bërë të mundur për kredimarrësit një zhvillim të biznesit të tyre dhe duke zënë 2% të vlerës totale të kredive të disbursuara për vitin 2022.

## Produktet



Një tjetër arritje e kënaqshme në treguesit e këtij viti është performanca e produktit Biznes i cili përbën 33% të Portofolit Aktiv, duke shënuar një rritje prej 3% nga viti i kaluar.

### Shpërdarja e Portofolit sipas Produkteve



# MENAXHIMI I PORTOFOLIT NË RISK

Kultura e fortë dhe ndërmarrja e sfidave për përmirësimin e vazhdueshëm, kanë mundësuar përputhshmërinë me modelin tonë të biznesit, të lidhur ngushtësisht me metodat efektive të menaxhimit të riskut të kredisë. Kjo qasje ka lejuar zhvillimin e portofolit tonë të kredisë, gjithnjë duke mbajtur në pararojë transparencën ndaj klientit, por edhe monitorimin e të gjitha proçedurave, edhe pas kredihënies.

Politikat e menaxhimit të riskut në ASF, janë projektuar në bazë të raporteve analitike dhe rishikohen vazhdimisht, për të respektuar limitet adekuate të risqeve ndaj të cilave ekspozohet institucioni.

Misioni i Departamentit të Menaxhimit të Riskut është që të sigurojë një strukturë, e cila menaxhon risqet që institucioni përballet përgjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, me qëllimin final arritjen e objektivave të vendosura dhe krijimin e një kulture të vendimmarrjeve me risk të kalkuluar. Këte proces e realizon duke:

- o identifikuar,
- o matur,
- o monitoruar,
- o manaxhuar riskun në institucion.

Departamenti i Menaxhimit të Riskut është pjesë e:

- o Komitetit të Kredive me Probleme & Provigjionimit
- o Komitetit të Kredive mbi 1 mln

Si pjesë të aktivitetit normal të biznesit, Departamenti i Menaxhimit të Riskut ka patur nën ndjekje gjatë vitit 2022 llojet e risqev, të ndara sipas kategorive/hënkategorive të mëposhtme:

KATEGORIA	NËN -KATEGORIA
<b>Strategjike</b>	Risku i Qeverisjes
	Risku Reputacional
	Risku Ligjor dhe i Përputhshmërisë (Ligjore)
<b>Financiare</b>	Risku i Kredise
	Risku i Dimensionit Social të Misionit
	Risku i Tregut
	Risku i Likuiditetit
	Risku i Normës së Interesit
	Risku i Kursit të Këmbimit
<b>Operacionale</b>	Risku i Kapitalit Njerëzor
	Risku i Integritetit të Sistemit/Teknologjisë



Viti 2022 pritej të ishte viti i rimëkëmbjes në rang global pas shumë vështirësive që shkaktoi Covid 19, por që në muajt e parë bota u përballur me luftën mes Rusisë dhe Ukrainës, e cila shkaktoi problematika të medha në ekonominë globale, dhe rrjedhimisht dhe në atë kombëtare.

Në ekonominë shqiptare, Inflacioni ka ardhur në rritje progresive gjatë vitit 2022, duke shënuar nivelin 8.1% në muajin Dhjetor. Rritja e inflacionit është nxitur nga rritja e çmimeve në tregun ndërkombëtar, por ajo ka filluar të transmetohet edhe në rritje të kostove të prodhimit dhe të pritjeve për inflacionin në vend. Për këto arsye, rritja e çmimeve në vend duket të ketë një bazë të gjerë dhe të jetë relativisht e qëndrueshme.

Agro & Social Fund i kushton një vëmendje të veçantë menaxhimit të rreziqeve të mundshme për të siguruar operativitet të qëndrueshme dhe të suksesshëm për Shoqërinë. Qëndrimi i Agro & Social Fund në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet në kohën e kërkuar, si në kushte normale ashtu edhe në kushte të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo duke rrezikuar të dëmtojë emrin e saj.

Menaxhimi i përgjegjshëm i rreziqeve nëpërmjet një qasjeje sistematike dhe të përhershme mbetet një ndër prioritetet e punës sonë. Me anë të mjeteve dhe raporteve të ndryshme analitike, stafi menaxhues identifikon dhe përcakton me kujdes rreziqet potenciale që mund të ndikojnë në njësinë tonë ekonomike duke përfshirë rrezikun e çmimit, rrezikun e kreditit, rrezikun e likuiditetit dhe rrezikun e flukseve monetare. Përdorimi i kontratave afatshkurtra, diversifikimi i portofolios dhe monitorimi i vazhdueshëm janë pjesë integrale e strategjive tona për menaxhimin e rreziqeve.

## CILËSIA E PORTOFOLIT TË KREDISË




Rritja e portofolit të kredisë ishte në nivele të kënaqshme gjatë vitit 2022, ndërkohë që niveli i PAR-it mbi 30 ditë, u mbyll me 4.47%.

Provizionimi, duke patur ndikim kyç në rezultatin financiar të ASF-së, është nën përgjegjësinë e Departamentit të Menaxhimit të Riskut, duke ndjekur rigorozisht rregullat e Bankës së Shqipërisë dhe të standarteve IFRS, nëpërmjet materializimit me procedura dhe politika rregullatore.



## Klasifikimi i Portofolit të Kredisë Dhjetor 2022



Lidhur me përbërjen e portofolit të kredive aktive, 95,5% klasifikohen si "Kredi Standarte", ç'ka dëshmon një cilësi stabël të portofolit. Fokusi në vijim, do të jetë përmirësimi në peshë i klasave mbi 30 ditë.

Në fokus të Departamentit të Menaxhimit të Riskut, edhe për këtë vit ushtrimor, ka qenë shtimi i vigjilencës ndaj parandalimit të mashtrimit, kimit financiar dhe financimit të terrorizmit. Janë ndjekur workshop-et e nevojshme nga entitetet relevante të fushës dhe trajnimet periodike të stafit tonë, për të qenë konform kërkesave rregullatore në fuqi.

# MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Përgjatë vitit 2022, Agro & Social Fund ushtroi aktivitetin e në funksion të përmbushjes së objektivave të saj strategjike dhe operacionale. Edhe ky vit pati ngjarje të cilat patën një ndikim domethënës në arritjen e këtyre objektivave, sic ishte fillimi i luftës në Ukrainë që pasoi me rritjen e lartë të çmimeve të karburantit, mallrave të konsumit, etj; në të gjithë tregun, si vendas ashtu dhe të huaj. Pavarësisht kushteve në të cilat na u desh të punojmë, sërish viti 2022 u shoqërua me arritje sa i takon objektivave të përcaktuara paraprakisht.

Në datat 10 – 12 Shkurt, ASF organizoi Analizën Vjetore të vitit 2022!

Ky forum konsiderohet si një tryezë pune ku strukturat dhe nivelet e menaxhimit paraqesin arritjet, projektet dhe sfidat, nevojat dhe objektivat për të ardhmen nëpërmjet një procesi pjesëmarrjeje dhe nëpërmjet një debati profesional për rritjen e performancës së punës në vazhdim.

Gjatë analizës vjetore, për të vlerësuar kontributin e dhënë përgjatë vitit 2022, u shpërndanë disa cmime për Oficerët më të mirë të Kredisë, si dhe Degës Lezhë, iu dha cmimi si Dega Rajonale me performancën më të mirë.

**Numri i punonjësve në mbyllje të vitit 2022: 84 punonjës**



Trajnimet në ASF nisën në muajin Shkurt dhe vazhduan gjatë gjithë vitit si me trajnimet fillestare për stafin e ri, ashtu dhe trajnime individuale e në grup për të rritur e forcuar njohuritë në çështje specifike të stafit si në degë, ashtu edhe në zyrë qendrore.

Edhe gjatë vitit 2022, ASF vazhdoi bashkëpunimin me Sëisscontact dhe Partners Albania, trajnime që kanë në fokus teknikat e shitjes dhe sjelljen përkundrejt klientit.

Trajnimet e ofruara gjatë vitit 2022 për stafin e ASF arrijnë numrin prej 33 trajnimesh.

## MARKETING 2022

Viti 2022 pati një ndryshim thelbësor sa i takon mënyrës së jetesës, duke qënë se Pandemia Covid, edhe pse me disa pasoja akoma të prekshme, mori një kthesë të rëndësishme. Numrat e të infektuarve nuk ishin në nivele të larta, pavarësisht që patëm akoma raste më Covid, duke bërë kështu që njerëzit t'u riktheheshin aktiviteteve normale, edhe pse me frikën që situata mund të përkeqësohej sërish. Gjatë vitit 2022, ASF ri-filloi përdorimin e metodave të ndryshme të marketingut, përfshirë marketingun fizik, gjithmonë duke ndjekur masat e duhura për ruajtjen e shëndetit të punonjësve dhe të të tjerëve.

Për herë të parë, gjatë muajit Tetor të vitit 2022, ASF ndërmori një fushatë publicitare në Top Albania Radio, ku gjatë gjithë muajit Tetor, nëpërmjet një spoti, ASF u dëgjua nga mijëra dëgjues.

Gjithashtu, gjatë vitit përveç marketingut individual dhe në grup të projektuara nga secila degë rajonale, u synuan dhe u mor pjesë në disa Panaire, me qëllim arritjen e sa më shumë klientëve potencial njëkohësisht.

Faqja e ëeb dhe rrjetet sociale ishin në fokus, me postime të ndryshme dhe në të gjithë treguesit e matshëm trendi i të dhënave ka qënë pozitiv në kahun rritës.

Lushnje,  
19 - 21 Maj 2022

Lezhe, Arte & Zeje  
20 Maj 2022

Gramsh,  
29 Tetor 2022

Korçë,  
Dega Rajonale



# IT, mbrojtja nga sulmet kibernetike ne fokus



Forcimi i sigurisë kibernetike, veçanërisht në periudhën kur lufta teknologjike po sofistikohet e po bëhet përherë e më e ashpër, ishte prioritet i lartë i punës. Situata mbi sigurinë u kthye çdo ditë në një sfidë, e cila kërkoi vëmendje, angazhim e bashkëpunim.

Në kushtet e një luftë kibernetike, Elementet ku u fokusua Siguria ishin:

- Siguria e aplikacioneve.
- Siguria e rrjeteve.
- Siguria e informacionit.
- Siguria End-user.
- Disaster Recovery Planning.
- Siguria Operacionale

ASF/DTI punoi në plotësimin e detyrimeve ligjore dhe në interes të ASF si biznes, në mbrojtje të informacionit duke kryer vlerësime të infrastruktures së brendshme TIK për boshllëqet hardwerike, softwerike, njerëzore, krahasuar me standartet minimale. Ndoqi e zbatoi paketën e masave/mjeteve dhe rekomandimeve për Sigurinë Kibernetike, por me së shumti i përshtati këto në kushtet e veta të zbatueshme DTI ka qënë pjesë e takimeve me autoritetet lokale mbi:

- Adresimin e nevojës së aplikimit të masave shtesë për mbrojtjen dhe sigurimin e informacionit financiar të qytetarëve, bizneseve. (si fokus i Qeverisë Shqiptare dhe prioritet i AKCESK)
- Nevojën për burime njerëzore të kualifikuara për të mbuluar funksionet e sigurisë së informacionit,
- Nevojën për transparencë dhe shkëmbim informacioni në rast incidentesh kibernetike që prekin infrastrukturën kritike të informacionit në nivel kombëtar
- Vendosjen e objektivave të përbashkët për rritjen e nivelit të sigurisë për mbrojtjen e informacionit financiar të qytetarëve, në terma të rritjes së transparencës, ngritjes së kanaleve të sigurta të komunikimit dhe forcimit të besimit.
- DTI mori pjesë në takime/trajnime të Autoritetit të organizuara në vazhden e rritjes së kapaciteteve profesionale të nevojshme për operatorët e infrastrukturave kritike në Shqipëri, stërvitje kibernetike me skenarë të mbështetur në praktikën më të mirë dhe bashkëbisedime me aktorët në treg lidhur me sigurinë.



*\* Motoja jone: Duhet punuar gjithnjë sikur të jesh i sulmuar, vetëm kështu mundet të jesh Alert dhe i gatshëm në mbrojtje të punës tënde dhe të pronësisë së kompanisë.*

# Performanca Sociale

Portofolet e IMF-ve shpesh kanë një pjesë të konsiderueshme të sektorit informal, një mbizotërim të aktiviteteve agro/tregtare dhe klientëve vulnerabël që kanë pak burime për të "zbutur" ndikimet e krizave. Këto popullata përgjithësisht kursejnë pak, dhe investojnë të gjitha burimet e tyre në aktivitetin e tyre ekonomik të përditshëm. Shumë prej këtyre mikrosipërmarrësve urbanë dhe ruralë mbështeten në këto burime të përditshme të ardhurash për nevojat e tyre bazë. Rritja e ndjeshme e çmimeve të produkteve të shportës bazë mund të nënkuptojnë se ata nuk mund të përballojnë të paguajnë për ushqimin, strehimin, kujdesin shëndetësor, etj. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 ASF ju është gjendur pranë klientëve me mundësi refinacimi ose riskedulimi në mënyrë që situata e pagesave mujore për ta të bëhej më komode dhe njëkohësisht të vazhdonin të ishin fitimprurës në aktivitetin e tyre të përditshëm. ASF edhe një herë tregoi se virtyti kryesor i mikrofinancës është se "nuk është vetëm e mundur dhe e nevojshme të zbatohen shërbime të përshtatura për më të varfërit – por mund të jenë edhe fitimprurëse".



## Impakti Social

**Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, Agro & Social Fund ka:**

**Shërbyer 2300 klientëve**

**Ruajtur 4300 & Krijuar 420 vënde pune**

**Përmirësuar jetën e 5600 fëmijëve**

**Financuar 250 sipërmarrje të reja**

**Shërbyer 60% klientëve rurale dhe 50% klienteve femra**

**Shërbyer 900 klientëve për Edukim dhe Shëndetësi**

**Shërbyer 300 klientëve për Efiçencë Energjike**

**Shërbyer 900 klientëve të rinj (grupmosha 18-35 vjeç)**

**ASF vepron në përputhje me Sustainable Development Goals (SDG). Në terma të përgjithshëm, aktiviteti i ASF ka një ndikim, në shkallë të ndryshme, në trembëdhjetë SDG.**

**#1: No Poverty**

**#2: Zero Hunger**

**#3: Good Health and Well-being**

**#4: Quality Education**

**#5: Gender Equality**

**#7: Affordable and Clean Energy**

**#8: Decent Work and Economic Growth**

**#9: Industry, Innovation, and Infrastructure**

**#10: Reduced Inequalities**

**#11: Sustainable Cities and Communities**

**#14: Life Below Water**

**#15: Life on Land**

**#17: Partnerships for the Goals**

# Projekte dhe Partnerë

**Kiva** - Gjatë vitit 2022 në kiva janë financuar \$ 1,364,870.00, duke i ardhur kështu në ndihmë investimeve në Bujqësi, Edukim, Shëndetësi, Grave në zonat ruarle, Bizneseve të Reja, Të Rinjve Sipërmarrës dhe Komuniteteve Vulnerabël

**“Dorcas Aid International” Albania - Projekti “PËR NXITJEN E SIPËRMARRJES NË RAJONIN E TROPOJËS NËPËRMJET KREDITIMIT”** do të zgjatet edhe për një periudhë 3-vjeçare, me qëllim vazhdimin e suportimit të familjeve në nevojë; dhe nga ana tjetër të nxitjes së mëtejshme të atyre familjeve që në fazën e parë u ndihmuan të nisnin një sipërmarrje.

**Albanian Development Guarantee Foundation** - Në sajë të bashkëpunimit me ADGF, ASF financon klientë (brenda fashës “Green ëindoë”) të cilët investojnë në aktivitetet e tyre, duke mbajtur në konsideratë edhe kursimin e energjisë edhe uljen e emetimit të CO2, me të paktën 20%. Nëpërmjet fashës “Regular ëindoë” financojmë sipërmarrës të zhvillojnë dhe zgjerojnë aktivitetet e tyre dhe, mundësisht, të punësojnë edhe të tjerë. Gjatë muajit Dhjetor të vitit 2022 nisën bisedimet për një bashkëpunim të ri, për kategorinë e bizneseve të reja (Start-Up).

**European Investment Fund (Fond i Komisionit Europian)** - Gjatë muajit Maj 2022 u finalizua marrëveshja me EIF. Sipas kësaj marrëveshje ASF mund të financojë klientë që kanë një biznes të licensuar, sipas disa termave specifik. Për shuma të caktuara, ky produkt e ka bërë ASF konkurrues në treg. Produkti EIF përkrah biznesin e formalizuar, me kushte specifike për mbrojtjen e mjedisit dhe përjashtimin e bizneseve, të cilat mund të shfrytëzojnë punën e fëmijëve, shfrytëzimin e burimeve të ndaluara, ndotjen e ambjentit, etj.

**SwissContact** – Gjatë vitit 2022 vijoi bashkëpunimi me SëissContact, në sajë të të cilit staf i ASF mësuan si t’ju shërbejnë më mirë të rinjve që duan të nisin sipërmarrje të reja. Nga ana tjetër oficerët e kredisë asituan të rinjtë për të kuptuar më mirë kredinë dhe parandalimin e mbingarkesës me borxhe.

**Frankfurt School** – Gjatë vitit 2022 vijoi bashkëpunimi me Frakfurt School, për financimin e aktivitetit të ASF dhe trajnimin e stafit menaxherial.

# KLIENTËT TANË

## Klajdi Purikisi

Klajdi është një sipërmarrës i ri nga Korça. Ai është i martuar dhe baba i lumtur i një fëmije të vogël. Për të siguruar jetesën e familjes ai punon si hidraulik. Së fundmi ai ka filluar të ofrojë shërbime edhe për instalimin e paneleve diellore. Përveç faktit që kjo është një fushë krejtësisht e re për të, ai i frikësohej faktit se duhet të punojë në lartësi. Për këtë Klajdi vendosi të regjistrohet në një kurs trajnimi se si të ishte i sigurt gjatë punës në ndërtime dhe instalime në lartësi. Falë kredisë së ASF-së, ai mundi të paguajë tarifën e kursit dhe tani është më i sigurt gjatë punës, si dhe ofron shërbim më të mirë për klientët e tij.



## Dile Margjini

Dile është një sipërmarrëse nga qyteti i Lezhës. Ajo punon bashkë me të shoqin në biznesin e tyre dhe janë shumë të kënaqur me punën që bëjnë. Për shkak të rritjes së kërkesës nga ana e klientëve, asaj iu desh të shtojë mall në punishten e saj, në mënyrë që të përballojë të gjitha kërkesat. Nëpërmjet financimit që ASF I mundësoi, Dile arriti të përmbushë të gjitha porositë e klientëve të saj. Dile është falenderuese për mundësinë që iu dha, gjë e cila ndikoi në rritjen e të ardhurave nga biznesi që ajo dhe i shoqi ushtrojnë.

# RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR



Ernst & Young Certified Auditors  
Albania Branch  
NUIB: K019110121  
Ibrahim Rugova Str, Sky Tower, 6<sup>th</sup> floor  
1001, Tirana, Albania

Tel: +3552419575  
ey.com

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin e Agro & Social Fund sh.p.k.

Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Agro & Social Fund sh.p.k. (më poshtë "Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2022, pasqyrën e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2022, dhe performancën financiare dhe flukseve të parasë për vitin e mbyllur më atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

### Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësi e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilitetit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbyshur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Informacione të tjera të Përfshira në Raportin Vjetor 2022 të Agro & Social Fund sh.p.k.

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Shoqërisë për vitin 2022, përgatitur në përputhje me nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Shoqërisë për vitin 2022 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohtjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundim që ka një pasiguri, ne duhet të tërhiqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Agro & Social Fund sh.p.k, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar  
Deqa në Shqipëri

Ernst & Young  
1 dhjetor 2023  
Tiranë, Shqipëri



Mario Vanjeli  
Auditues Ligjor

Mario Vanjeli



# BILANCI

## BILANCI (Shuma në mij lek)

## BALANCE SHEET (Amounts in thousands of Lek)

<b>Aktivitet</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>	<b>Assets</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	100,775	120,380	Cash and cash equivalents
Hua dhe paradhënie për klientët	964,730	830,119	Loans and advances to customers
Aktivitet afatgjata materiale	11,572	14,035	Property and Equipment
Aktive të tjera	11,412	3,698	Other assets
Të drejtat mbi Asetet	41,794	45,714	Right of use Assets
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>1,130,283</b>	<b>1,013,946</b>	<b>Total assets</b>
<b>Detyrimet dhe Kapitali i vet</b>			<b>Liabilities and shareholder's equity</b>
Detyrimet	722,545	622,126	Liabilities
Huate	41,086	46,533	Borrowings
Detyrimet mbi Qeratë	16,852	24,245	Lease Liability
Detyrime të tjera	780,483	692,903	Other liabilities
<b>Kapitali i vet</b>			<b>Shareholder's equity</b>
Kapitali aksionar	289,375	289,375	Share capital
Humbje të mbartura	31,667	(8,489)	Accumulated losses
Fitimi i vitit	28,758	40,156	Profit of the year
<b>Totali i detyrimeve dhe Kapitali i vet</b>	<b>1,130,283</b>	<b>1,013,946</b>	<b>Total liabilities and shareholder's equity</b>

## PASQYRA E TË ARDHURAVE / INCOME STATEMENT

(Shumat në mij Lek)

(Amounts in thousands of Lek)

# PASQYRA E TË ARDHURAVE

(Shumat në mijë Lekë)

	2022	2021
<b>Interesa</b>		
Të ardhura nga interesi	245,434	221,519
Shpenzime për interesa	(39,230)	(36,084)
Të ardhura neto nga interesi	<b>206,204</b>	<b>185,435</b>
Të ardhura/(Shpenzime) të tjera	1,191	1,652
<b>Detyrimet dhe Kapitali i vet</b>		
<b>Shpenzime operative</b>		
Zhvierësimi	(20,097)	(17,483)
Shpenzime personeli	(106,061)	(85,177)
Humbje nga zhvierësimi i huave	(25,150)	(23,140)
Shpenzime të tjera	(21,187)	(17,300)
Fitim/(humbje) neto nga kurset e këmbimit	247	4,929
<b>Totali i shpenzimeve operative</b>	<b>(172,248)</b>	<b>(138,172)</b>
<b>Fitim/(humbja) përpara tatimit</b>	<b>35,147</b>	<b>48,916</b>
Tatim fitimi	(6,389)	(8,760)
<b>Fitim/(humbja) për vitin</b>	<b>28,758</b>	<b>40,156</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, pas tatimit	-	-
<b>Totali i të ardhurave/(humbjes) gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>28,758</b>	<b>40,156</b>

# PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË

(Shumat në mijë Lekë)

Pasqyra e flukseve të monetare			Statement of cash floës
<i>(Shumat në mijë Lek)</i>			<i>(Amounts in thousands Lek)</i>
	2022	2021	
<b>Flukset monetare nga aktivite operacionale</b>			<b>Cash floë from operating activities</b>
Fitimi / (Humbja) për vitin	35,147	48,916	Profit / (Loss) for the year
<i>Korrigjime për:</i>			<i>Adjustments for:</i>
Zhvlërësimi			Depreciation of property and equipment
Zhvlërësimi në Të drejtat mbi Asetet	3,381	3,714	Depreciation of Right of use Assets
Pakësime neto në Aktivet Afatgjata	16,716	13,769	Disposal of Fixed Assets
	(87)	-	Impairment losses on loans to customers
Humbje nga zhvlërësimi i huave	25,150	23,140	Interest income
Të ardhura nga interesi	(245,434)	(221,519)	Interest expenses
Shpenzime për interesa	29,940	36,637	
<i>Ndryshime në:</i>			<i>Changes in:</i>
Hua dhe paradhënie për klientët	(161,609)	(119,663)	Loans to customers
Aktive të tjera	(5,150)	3,273	Other assets
Detyrime të tjera	(7,394)	8,119	Other liabilities
	<b>(309,340)</b>	<b>(203,614)</b>	
Interesi i arkëtuar	247,281	224,040	Interest received
Interesi i paguar	(22,976)	(39,103)	Interest paid
Tatimi mbi të ardhurat i paguar	(8,953)	(5,022)	Income tax paid
<b>Flukset monetare nga / (te perdorura) ne aktivite operacionale</b>	<b>(93,988)</b>	<b>(23,699)</b>	<b>Net cash from/ (used in) operating activities</b>
(Shtesa)/ pakësime neto në aktivet afatgjata materiale	(927)	(2,735)	Net (additions)/disposals of property, equipment
<b>Flukset monetare përdorur në aktivite investuese</b>	<b>(927)</b>	<b>(2,735)</b>	<b>Net cash used in investing activities</b>

# Partnerët Tanë





[www.asf.al](http://www.asf.al)



[agrosocialfund\\_shpk](https://www.instagram.com/agrosocialfund_shpk)



[Agro Social Fund](https://www.linkedin.com/company/agro-social-fund)



[Agro & Social Fund](https://www.facebook.com/Agro-Social-Fund)



[info@asfund.org](mailto:info@asfund.org)



+355 46 31 57 43



Rruga "Nikolla Lena" Hyrja 1, Ap.25